VENDIM
Nr.811, datë 6.10.2010

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS, PËR UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË, PËR NDËRTIMIN E NJË KAMPUSI TË RI UNIVERSITAR, TË PRONËS, TOKË BUJQËSORE, TË NDODHUR NË FSHATIN AKËRNI, KOMUNA NOVOSELË, NË QARKUN E VLORËS, AKTUALISHT NË DISPOZICION TË AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE, SI FOND PËR KOMPENSIMIN FIZIK, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.868, DATË 18.6.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KRIJIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT FIZIK NGA FONDI I TOKËS BUJQËSORE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të nenit 82 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, për nevojat e universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, për ndërtimin e një kampusi të ri universitar, të pronës së paluajtshme, tokë bujqësore, me numrat kadastralë të parcelave 41, 42, 68, 69, 70 dhe 66, 71, 72, 73, 74, me një sipërfaqe prej 135,6 (njëqind e tridhjetë e pesë presje gjashtë) ha, të ndodhur në fshatin Akërni, komuna Novoselë, të qarkut të Vlorës, aktualisht në pronësi të shtetit, vënë në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si fond për kompensimin fizik.
2. Prona e paluajtshme, e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, hiqet nga lista e pronave që i bashkëlidhet vendimit nr.868, datë 18.6.2008 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore".
3. Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, pas marrjes në përdorim të pronës së përcaktuar në këtë vendim, i ndalohet ta ndryshojë destinacionin, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.
4. Ngarkohen Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha